



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

DATE/A:	20.07.2026
REFERENCE:	0110/05-0041800/26
PËR/ZA/TO:	Zaj. Sofije Rushiti Peci – Zytare për Informim
Cc:	z. Faton PEÇI, Kryetar i Komunës
NGA/OD/FROM:	z. Enes Kacapor – Koordinator i Komitetit Komunal Veprues
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Shpallje e Diskutimit Publik



Me qëllim të nxitjes dhe sigurimin e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politikëbërjes dhe vendimarrjes në Kuvendin e Komunës së Mitrovicës së Jugut, duke u bazuar në nenin 68, paragrafi 68.3 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; nenin 93 të Statutit të Komunës së Mitrovicës së Jugut Nr. 02-060/01-0056607/20-4, dt. 24.09.2020; Rregulloren (MAPL) Nr. 02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës; Udhëzim Administrativ (Mapl) Nr.04/2023 për Administratë të Hapur në Komunë, Komuna shpall:

DISKUTIM PUBLIK

Për Planin Lokal i Veprimit për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Komunën e Mitrovicës së Jugut 2026

Njoftohen të gjithë qytetarët, grupet e interesit dhe palët tjera të interesuara që të marrin pjesë në konsultim publik, i cili do të mbahet ditën e marte, me datën 28/07/2026, në Sallën e Kuvendit të Komunës, duke filluar nga ora **10:00 h.**

Duke pasur në konsideratë rëndësinë për Hartimin e Planit Lokal i Veprimit për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Komunën e Mitrovicës së Jugut 2026, pjesëmarrja e publikut në këtë fazë të procesit është e nevojshme, prandaj qytetarët dhe të interesuarit e tjerë nga dita e publikimit të këtij njoftimi, të gjitha komentet, vërejtjet, sugjerimet dhe pikëpamjet mund t'i japin përmes e-Mail adresave elektronike tek Koordinatori i Komitetit Komunal Veprues: enes.kacapor@rks-gov.net.

Bashkangjitur gjeni Draft-Planin Lokal i Veprimit për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Komunën e Mitrovicës së Jugut 2026.